

MNN QENDRORE



MISIONET NDËRKOMBËTARE NAZARETASE

15 Tetor 2025

NJË SHIKIM I SHPEJTË MNN



Fondi i Ungjillizimit Botëror dhe Oferta e Falenderimeve



[Klikoni këtu për ta shikuar këtë video në shumë gjuhë.](#)

Dhënia për Ungjillizimit Botëror nxit misionin e Kishës së Nazaretasit duke kombinuar dhuratat e çdo personi dhe të çdo kishe për të financuar shërbesat kudo në botë. Çdo kishe i kërkohet të ndajë një pjesë të të ardhurave të saj totale me qëllim që të bëjë dishepuj si Krishti në kombe.

Pse ekziston Fondi i Ungjillizimit Botëror?

Në vitin 1923, Kisha e Nazaretasit kaloi në një sistem financimi të centralizuar të quajtur Buxheti i Përgjithshëm. Në vitin 1997, emri ndryshoi në Fondi i Ungjillizimit Botëror, por qëllimi mbeti i njëjtë: të mbështesë shërbesa të vlefshme përmes financimit të vazhdueshëm të misionit. Fondi i Ungjillizimit Botëror siguron mjetet e përgjithshme dhe rrjetin e misionit që të gjitha shërbesat Nazaretase kanë nevojë. Dhuratat tuaja krijojnë dhe mbështesin misionin, dhe bëjnë të mundur përhapjen e mesazhit transformues të shpresës dhe shpëtimit të Krishtit në botë përmes Kishës së Nazaretasit.

Si funksionon Fondi i Ungjillizimit Botëror?

Kur ju jepni, fondet shkojnë në Zyrën e Thesarit të Përgjithshëm, ku fondet shpërndahen në gjashtë rajonet e botës, për misionarët dhe shërbesat në mbarë globin. Fondi i Ungjillizimit Botëror jo vetëm që u siguron shërbesave në terren fondet që u nevojiten, por gjithashtu përdoret për të siguruar përmbushjen e kërkesave ligjore, shtetërore dhe administrative që misionet të jenë sa më të sigurta dhe të qëndrueshme për vitet që vijnë.

Çfarë është Fondi i Ungjillizimit Botëror?

Fondi i Ungjillizimit Botëror është themeli për gjithçka që Perëndia po bën përmes Kishës globale të Nazaretasit. Metoda jonë kryesore e misioneve përmes dhembshurisë, ungjillizimit dhe edukimit realizohet me Dhënien e Ungjillizimit Botëror. Ja disa shembuj të shërbesave që dhënia juaj ndaj Ungjillizimit Botëror realizon përmes financimit të drejtpërdrejtë të mbështetjes së rrjetit të shërbesës:

- Kisha dhe shërbesa të reja
- Misionarë
- Shërbesa rajonale
- Burime dhe literaturë të Krishterë
- Edukim për Shenjtërinë
- Shërbesa me partnere si Partnerët e të Korrurave Filmi JEZUS, Shërbesa e Dhembshurisë Nazaretase dhe shumë të tjera.

Si mbledhet Fondi i Ungjillizimit Botëror?

Shumica e këtij fondi vjen direkt nga kongregacionet lokale si pjesë e planit Financimi i Misionit. Kur ju jepni, kisha juaj ndan një pjesë të dhuratës suaj me kishën botërore të Nazaretasit. Objektivi i Fondit të Ungjillizimit Botëror për çdo kishë është 5.5% e të ardhurave të saj totale vjetore minus fondet për Misione të Veçanta.

Disa kongregacione zgjedhin të mbledhin fonde përmes Ofertës së Pashkëve dhe Ofertës së Falënderimeve. Për burimet që lidhen me Ofertën e Falënderimeve, [klikoni këtu](#). Këto dy oferta janë mbledhur çdo vit për më shumë se 100 vjet. Ekipi i Zhvillimit të Administrimit siguron materiale promovuese dhe informuese për të ndihmuar kishat të komunikojnë ofertat tek kongregacionet e tyre. Kishat përdorin gjithashtu mënyrën Premtim Besimi për të mbledhur fonde gjatë gjithë vitit. Pastorët dhe drejtuesit e MNN-së inkurajohen të ndihmojnë njerëzit që të kuptojnë dhe të kontribojnë për misionin global përmes Fondit të Ungjillizimit Botëror. Shumë kisha zgjedhin të japin më shumë se objektivi 5.5% për misionin, dhe këto dhurata bëjnë ndryshim të madh në jetë njerëzish.

Faleminderit

Mbështetni punën e Kishës së Nazaretasit përmes Fondit të Ungjillizimit Botëror. Dhuratat tua personale arrijnë në të gjithë botën duke ndryshuar jetë dhe duke transformuar zemra në emrin e Jezusit... duke bërë dishepuj si Krishti në kombe.

Asnjë nga shërbesat që mbështet Ungjillizimi Botëror nuk do të ishte e mundur pa dhuratat e njerëzve si ju. Ju bëni të mundur përhapjen e ungjillit në të gjithë botën. Faleminderit për besnikërinë tuaj për të dhënë dhe për t'u lutur për punën misionare të Nazaretasit kudo në botë.

Për të dhënë onlinet, [klikoni këtu](#).

**Rajonet: Afrika, Azi-Paqësori, Euroazia,
Mesoamerika, Amerika e Jugut, SHBA-
Kanada**



A MUND TË SHËRBENI?

A po ju thërret Zotipër të shërbyer në rajonin e Euroazisë? Për më shumë informacion, klikoni [këtu](#).

MNN Qendrore është e disponueshme në një arkiv në formatin PDF. Për të lexuar botimet e mëparshme, klikoni [këtu](#).

